

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT  
SEKSIONI I KATËRT

**VENDIM**

**Ankimi nr. 50308/13**

**VASIL SHKARPA KUNDËR SHQIPËRISË**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur më 15 shtator 2015, si Komitet, e përbërë nga:

Nona Tsotsoria, *President*,

Ledi Bianku,

Paul Mahoney, *gjyqtarë*,

dhe Fatoş Aracı, *zëvendësregjistrues* i Seksionit,

në lidhje me ankimin e mësipërm të paraqitur më 31 korrik 2013,

në lidhje me deklaratimet formale në të cilat pranohet një zgjidhje, në mënyrë miqësore e çështjes, pas shqyrtimit, vendos si më poshtë:

**FAKTE DHE PROCEDURA**

Ankuesi, z. Vasil Shkarpa, është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1961 dhe banues në Berat.

Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agentja e saj, znj. A. Hicka nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

Ankuesi u ankua se kishte pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës, për sa ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të formës së prerë të gjykatës, të dhënë në favor të tij, në të cilin urdhërohej rikthimi në punë i ankuesit, përpos pagesës së rrogave të prapambetura deri në rikthimin e tij në punë.

Më 22 prill dhe 13 maj 2015, Gjykata mori deklaratat për zgjidhje miqësore, të firmosura nga palët, sipas të cilave ankuesi binte dakord të hiqte dorë nga çdo pretendim i mëtejshëm kundër Shqipërisë, në lidhje me faktet të cilat çuan në këtë ankim kundër një sipërmarrjeje nga Qeveria për të zbatuar plotësisht brenda tre muajve vendimin vendas të formës së prerë të dhënë në favor të tij, dhe t'i paguante atij 3,300 euro (tre mijë e treqind euro) për të mbuluar çdo dëm jomonetar, si edhe kostot dhe shpenzimet.

Sipas deklaratave për zgjidhje miqësore, shuma e mësipërme do të konvertohet në vlerën monetare vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe nuk do të përfshijë ndonjë taksë e cila mund të jetë e zbatueshme. Ajo do të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast se nuk është Qeveria nuk paguan këtë shumë brenda periudhës së përcaktuar prej tre muajsh, ajo ndërmerr të paguajë interes të thjeshtë për të, që nga përfundimi i kësaj periudhe deri në zgjidhje, në një normë të barabartë me normën marxhinale të huas plus pikë trepërqindëshe. Zbatimi i plotë i vendimit të formës së prerë, brenda tre muajve, dhe pagesa e mësipërme do të përbëjnë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

**LIGJI**

Gjykata i referohet marrëveshjes miqësore të arritur midis palëve, duke përfshirë edhe rikthimin në pozicionin e punës së ankuesit, siç urdhërohet nga vendimet e gjykatave vendase. Ajo sigurohet se marrëveshja bazohet në respektimin e të drejtave njerëzore siç përcaktohet në Konventë dhe në protokollet e saj dhe nuk gjen asnjë arsye për të justifikuar një shqyrtim të mëtejshëm të ankimit. Për sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, në mënyrë unanime, Gjykata:

*Vendos* ta heqë ankimin nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 39 të Konventës.

E përgatitur në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 8 tetor 2015.

ZĖVENDĖSREGJISTRUES

**Fatoş Araci**

PRESIDENT

**Nona Tsotsoria**